



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 429/7 Prot.

Tiranë, më 01.08.2018

VENDIM

Nr.75, datë 01.08.2018

“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e lirimit nga shërbimi civil, në kuadër të ristrukturimit si dhe gjatë procedimit disiplinor ndaj nëpunësës ***”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe materialit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësës *****,

VËREJ SE

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 429 prot., datë 03.05.2018, kërkesja ***** ka ngritur pretendimin për moszbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, gjatë procesit të transferimit të përhershëm dhe më pas lirimit nga shërbimi civil, në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Akredituara nga Bashkimi Evropian, si dhe gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, punonjësja ***** ka qenë nëpunëse civile, në pozicionin “Përgjegjës Sektori IPA I”, në ish Ministrinë e Integritit Evropian dhe pas kryerjes së procedurës së konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë, në datën 01.03.2017 është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike në pozicionin “Drejtor”, i Drejtorisë së Metodologjisë dhe Sigurimit të Cilësisë, në

Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian – kategoria e pagës II-b.

Me implementimin e vendimit nr. 639, datë 06.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë*”, me anë të të cilit është përcaktuar numri i përgjithshëm i personelit të këtij institucioni dhe është miratuar struktura e re e tij, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit me urdhrin nr. 119, datë 09.11.2017, “*Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë*”.

Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit, ka përgatitur propozimin me shkrim për transferimin e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve janë prekur nga ristrukturimi. Në përfundim të këtij procesi, është konstatuar, se, pozicionin i punës “*Drejtor i Drejtorisë së Metodologjisë dhe Sigurimit të Cilësisë*”, në të cilin ka qenë e emëruar nëpunësja në fjalë, është suprimuar. Në këto kushte, Komisioni i Ristrukturimit me vendimin nr. 6473 prot., datë 09.11.2017, ka propozuar transferimin e punonjësës ***** nga pozicioni i mëparshëm në pozicionin “*Drejtor*”, i Drejtorisë së Financës dhe Juridike – kategoria e pagës II-b, në të njëjtin institucion, në *Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë*.

Më tej, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 6473/9 prot., datë 09.11.2017, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, ka nxjerrë aktin për transferimin e nëpunësës në pozicionin e sipërcituar.

Rezulton se, nëpunësja ***** nuk ka qenë dakord me aktin administrativ të sipërcituar dhe për këtë arsye, brenda afatit 5 ditor, i është drejtuar njësisë përgjegjëse (DAP) me shkresën nr. 228/16 prot., datë 13.11.2017, nëpërmjet të cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit dhe revokimin e propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, me arsyetimin se nuk përmbush kriteret e posaçme të pozicionit të punës, në të cilin po transferohej.

Në rastin konkret, kjo nëpunëse ka pretenduar se transferimi i saj nuk është i bazuar në ligj, pasi në kuptim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Juridike*”, nëpunësi zbatues në institucion, duhet të përmbush disa kriteret specifike. Konkretisht në nenin 12, të këtij ligji përcaktohet se: “*Nëpunësi zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në vartësi direkte nga nëpunësi*

autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion”, kritere të cilat nëpunësja ***** pretendon se nuk i përmbush, pasi disponon vetëm diplomë në shkencat juridike.

Departamenti i Administratës Publike ka marrë në shqyrtim këtë çështje dhe me shkresën nr. 6473/16 prot., datë 26.12.2017, i ka kthyer përgjigje nëpunëses ***** , duke nënvizuar se pretendimet e saj janë të pabazuara, pasi atributet e nëpunësit zbatues, në referencë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe të strukturës aktuale të institucionit të Agjencisë së Auditimit, i gëzon drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat, që në rastin konkret është “Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Administratës”, pranë Drejtorisë së Financës dhe Juridike.

Në kushtet kur, ky transferim është vlerësuar si një veprim administrativ i kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, rezulton se, nëpunësja ***** , e emëruar pas ristrukturimit në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Juridike”, në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë, me shkresën nr. 3 prot., datë 03.01.2018, ka shprehur miratimin e saj.

Me përfundimin e procedurës së ristrukturimit, në zbatim të nenit 2, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rekomandimeve të njësisë përgjegjëse, rezulton se, institucioni i Agjencisë së Auditimit (AAPAA), me qëllim realizimin dhe përmbushjen e veprimeve buxhetore të institucionit, ka kërkuar pranë Ministrisë së Financave miratimin si “Nëpunës zbatues”, të nëpunëses ***** , me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Administratës”.

Në lidhje me këtë kërkim, konstatohet se, Ministria e Financave me shkresën nr. 660/1 prot., datë 29.01.2018, “Mbi nëpunësin zbatues për Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës akredituar nga Bashkimi Evropian”, ka refuzuar miratimin e nëpunëses ***** në cilësinë e nëpunësit zbatues, me arsyetimin se, në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kjo nëpunëse nuk përmbush kriterin e vartësisë direkte nga nëpunësi autorizues.

Rezulton se, Departamenti i Administratës Publike, pasi është njohur me qëndrimin e mbajtur nga Ministria e Financave, nëpërmjet shkresës nr. 713/1 prot., datë 08.02.2018, ka kërkuar prej Komisionit të Ristrukturimit rishikimin e vendimit të mëparshëm nr. 6473 prot., datë 09.11.2017, për transferimin e nëpunëses ***** . Në përfundim të procesit të rishqyrtimit, Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka konkluduar në pamundësinë e sistemimit të nëpunëses në fjalë në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori në institucionin e AAPAA ose në institucione të tjera të shërbimit civil, me vendimin nr. 42 prot., datë 12.02.2018, ka propozuar ndërprerjen e marrëdhënies financiare në shërbimin civil.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të këtij institucioni, në mbështetje të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit, me aktin nr. 42/1 prot., datë 12.02.2018 ka vendosur lirim nga shërbimi civil për nëpunësen *****, duke i njohur të drejtën e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë e punës dhe mundësive që i njihen prej pikës 8 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Më tej, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar, rezulton se, Drejtori i Përgjithshëm i AAPAA, në cilësinë e eprorit direkt, ka kërkuar me shkresën nr. 30 prot., datë 01.02.2018, fillimin e ecurisë disiplinore, ndaj nëpunëses *****, me pretendimin e mospërmbushjes së detyrave funksionale në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Juridike. Në kuptim të nenit 57, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, mospërmbushja e detyrave funksionale të pozicionit të punës është klasifikuar si shkelje e rëndë dhe për këtë arsye, në zbatim të nenit 59, pika 2, të ligjit në fjalë, eprori direkt ja ka referuar për shqyrtim Komisionit Disiplinor.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme ligjore, rezulton se me urdhrin nr. 4, datë 01.02.2018, (i ndryshuar) është ngritur Komisioni Disiplinor, i cili ka filluar aktivitetin e tij, duke siguruar respektimin e kërkesave formale të procedurës së parashikuar nga pika 7, e nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të tilla si e drejta e nëpunësit të interesuar, për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejta për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe e drejta për t’u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, Komisioni Disiplinor gjatë shqyrtimit të shkeljeve të pretenduara ndaj nëpunëses *****, ka ardhur në dijeni të faktit se, me vendimin nr. 42 prot., datë 12.02.2018, të Komisionit të Ristrukturimit, për nëpunësen në fjalë është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil. Ndodhur në këto kushte, Komisioni Disiplinor me aktin nr. 30/9 prot., datë 16.02.2018, ka vendosur ndërprerjen e procedimit disiplinor nga ky komision dhe kalimin e këtij procedimi për kompetencë tek eprori direkt, me arsyetimin se shkeljet e kryera nga kjo punonjëse, të cilat konsistojnë në mospërmbushjen e detyrave funksionale të pozicionit të Drejtorit të Financës dhe Juridike, në kushte e saj konkrete, nuk përbëjnë shkelje të rëndë, por përbëjnë shkelje të lehtë disiplinore.

Në zbatim të dispozitave që rregullojnë institutin e procedimit disiplinor, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Auditimit, pas marrjes dijeni të vendimmarrjes së Komisionit Disiplinor, me vendimin nr. 30/10 prot., datë 16.02.2018, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses në fjalë. Në përmbajtje të këtij vendimi, rezulton se, motivacioni i marrjes së masës disiplinor është refuzimi në mënyrë të vazhdueshme i

detyrave funksionale të pozicionit të punës, në të cilin kjo nëpunëse është transferuar në kuadër të ristrukturimit të institucionit.

Në vlerësim të rrethanave si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se veprimet administrative të kryera gjatë procedurës së transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të AAPAA, si dhe gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor, vijnë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij si dhe të ligjeve specifike që rregullojnë aspekte të veçanta të marrëdhënies në shërbimin civil.

Në rastin konkret, rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse (DAP), kanë gabuar në zbatimin e ligjit material, në drejtim të vlerësimit/analizës së kriterëve dhe kushteve që duhet të përmbushë nëpunësi civil, i cili ushtron funksionet e nëpunësit zbatues. Neni 12, pika 1, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, përcakton në mënyrë eksplicite kriteret që duhet të përmbushë nëpunësi zbatues i njësisë publike, konkretisht:

- a. *Të jetë drejtues i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike dhe të jetë në vartësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë;*
- b. *Të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë të ekuivalentuar me të;*
- c. *Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në profesion.*

Referuar dispozitës së mësipërme, e cila rezulton të ketë qenë në fuqi dhe të mos ketë pësuar ndryshime ligjore në momentin e realizimit të procedurës së ristrukturimit të AAPAA, vërehet se, nëpunësja në fjalë në asnjë moment nuk ka përmbushur kriteret e nëpunësit zbatues. Si rrjedhim, pretendimi i njësisë përgjegjëse se, faktet e parashtruara nga Ministria e Financave në lidhje me këto kriteret, nuk ekzistojnë në momentin e shqyrtimit të transferimit të nëpunëses ***** në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Juridike*”, nuk qëndron.

Në lidhje me këtë fakt, Komisioneri vëren se, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me konstatimin e paligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm të nëpunëses *****, ka kërkuar prej Komisionit të Ristrukturimit rishqyrtimin e kësaj vendimmarrjeje. Rezulton se, në zbatim të nenit 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, Komisioni i Ristrukturimit ka rishikuar propozimin e mëparshëm për transferimin e nëpunëses në fjalë në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Juridike*” dhe pas rishqyrtimit të rrethanave të çështjes, me aktin nr. 42 prot./, datë 12.02.2018, ka propozuar përfundimin e

marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen ***** duke arsyetuar pamundësinë e transferimit të saj në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Duke analizuar elementët proceduralë të veprimit administrativ të lirimit nga shërbimi civil në kuadër të ristrukturimit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se ajo është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil”. Kjo për faktin se, në aktin e lirimit nga shërbimi civil, nëpunëses ***** i janë njohur të drejtat e sanksionuara në pikën 7 dhe 8, të ligjit në fjalë, konkretisht e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë si dhe e drejta e konkurrimit si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, brenda periudhës 2 vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Me qëllim garantimin e të drejtës së parashikuar në dispozitën e mësipërme, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton se në trajtimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses ***** janë zbatuar gabim kriteret ligjore të cilat rregullojnë mënyrën e vlerësimit dhe klasifikimit të shkeljeve disiplinore dhe nuk është mbajtur parasysh evidentimi i gjithë elementëve përbërës të një shkelje disiplinore.

Në rastin konkret, rezulton se, nëpunësja ***** ka kryer shkelje disiplinore gjatë kryerjes së detyrës “Drejtor i Financës dhe Juridike”, të cilat konsistojnë në refuzimin dhe mospërbushjen e vazhdueshme të detyrave funksionale të këtij pozicioni. Nëse vërtet do të ishim para një natyre të tillë shkelje, siç është mospërbushja dhe refuzimi i vazhdueshëm i plotësimit të detyrave funksionale, në vështrim të nenit 57, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, do të ishim para një shkelje të rëndë disiplinore dhe në këto kushte, në referencë të nenit 59, pika 2, të po këtij ligji, organi kompetent për shqyrtimin e këtyre shkeljeve është Komisioni Disiplinor.

Në analizë për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se, Komisioni Disiplinor ka gabuar në zbatimin e ligjit material dhe atij procedural, si në drejtim të klasifikimit të llojit të shkeljes disiplinore, duke vlerësuar shkeljen e pretenduar si shkelje të lehtë (sipas pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” shkelje të lehta konsiderohen vetëm shkeljet e mëposhtme: a. Mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë punë; b. Shkelja e rregullave të etikës; c. Sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun; d. Kryerja, brenda dhe jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi) ashtu dhe më pas, kur ka vendosur ndërprerjen e procedimit disiplinor dhe kalimin e shqyrtimit të çështjes tek eprori direkt.

Referuar përcaktimeve të dispozitave të mësipërme, në rastin konkret, Komisioni Disiplinor nga pikëpamja formale, duhet të vlerësojë në përputhje me kërkesat ligjore, nëse në veprimet ose mosveprimet e nëpunëses së proceduar, kishte elementë të thyerjes shumë të rëndë të disiplinës në punë dhe nëse nuk evidentonte elementë të një natyre të tillë, proceduralisht, duhej të kryente rikualifikimin e veprës dhe të përfundonte ecurinë me një vendim për caktimin e një mase disiplinore të përshtatshme, ose përfundimin e procedimit disiplinor, nëse nuk evidentoheshin elementë të ndonjë thyerje disiplinore, pa qenë nevoja për kalimin e rastit për shqyrtim tek eprori direkt.

Në përmbajtje të ecurisë disiplinore, evidentohet fakti se, procedimi disiplinor ndaj nëpunëses ***** është i lidhur me paligjshmërinë e aktit administrativ nr. 6473/9 prot., datë 07.11.2017, të Departamentit të Administratës Publike, nëpërmjet të cilit është vendosur transferimi i përhershëm i kësaj nëpunëse në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Juridike”, pozicioni i cili është vlerësuar nga Ministria e Financave, i papërshtatshëm për këtë nëpunëse.

Për sa më sipër, në kushtet e konstatimit të paligjshmërisë së transferimit të nëpunëses në fjalë, në pozicionin për të cilin është pretenduar mospërbushja e detyrave funksionale, Komisioni Disiplinor, në seancën e mbajtur në datën 16.02.2018, duhet të kishte shqyrtuar çështjen duke synuar evidentimin e gjithë elementëve objektivë dhe subjektivë për ekzistencën e një thyerje disiplinore, si veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme, rrethanat e kryerjes së shkeljes, natyrën dhe rëndësinë e saj dhe sidomos, ekzistencën e elementit faj në këto veprime apo mosveprime.

Me evidentimin e mungesës së lidhjes shkakësore mes veprimeve/mosveprimeve me pasojat e ardhura, si dhe të mungesës së elementit të fajit në këto veprime, Komisioni Disiplinor, në zbatim të nenit 17, germa “a” dhe “b”, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, duhet të kishte vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore dhe pushimin e saj, duke arsyetuar se mospërbushja e detyrave funksionale në rastin e nëpunëses ***** nuk përmban elementë të fajit, si dhe elementë të tjerë të shkeljes disiplinore.

Si përfundim, për të gjitha arsyet që janë analizuar sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se, akti administrativ nr. 30/9 prot., datë 16.02.2018, i Komisionit Disiplinor, për ndërprerjen e ecurisë disiplinore dhe kalimin e shqyrtimit të saj pranë eprorit direkt, si dhe akti nr. 30/10 prot., datë 16.02.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të AAPAA, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, janë akte, të cilat në kuptim të nenit 109, pika “d”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përbëjnë akte administrative të paligjshme, e

për këtë arsye, në referencë të nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, këto akte duhet të shfuqizohen.

Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni Disiplinor i ngritur me urdhrin nr. 4, datë 01.02.2018, (*i ndryshuar*), për shqyrtimin e shkeljes disiplinore të pretenduar ndaj nëpunëses *****, duhet të anulohet pjesërisht aktin nr. 30/9 prot., datë 16.02.2018, duke vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses në fjalë.

Më tej, në vijim të këtij veprimi administrativ, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Auditimit (AAPAA), duhet të kryejë procesin e anulimit të vendimit nr. 30/10 prot., datë 16.02.2018, "*Për marrjen e masës disiplinore "Vërejtje"*", ndaj nëpunëses *****.

Me anulimin e këtyre akteve administrative dhe me qëllim garantimin e të drejtës së sanksionuar në nenin 50, pika 8, germa "a", të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian, si dhe njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, duhet të fshijnë masën disiplinore "*Vërejtje*", ndaj nëpunëses ***** , nga dosja personale e saj, si dhe nga regjistri përkatës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ në lidhje me pretendimin e *nëpunëses* ***** , për paligjshmëri në procedurën e lirimimit nga shërbimi civil, në kuadër të ristrukturimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian, pasi nuk u konstatuan shkelje ligjore nga ana e subjekteve që kanë realizuar procesin e ristrukturimit.
2. Të kërkojë nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian, të anulohet pjesërisht vendimin nr. 30/9 prot., datë 16.02.2018, në pjesën ku shprehet "*Kalimin e procedimit disiplinor tek eprori direkt për vijimin e procedurave për shkelje të lehtë*", si një akt i dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe të vendosë pushimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses *****.

3. Të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian, të shfuqizojë vendimin nr. 30/10 prot., datë 16.02.2018, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, si një akt të paligjshëm, të dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
4. Të kërkojë nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian dhe nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, të fshijnë masën disiplinore “Vërejtje”, nga dosja personale e nëpunëses ***** si dhe nga rregjistri përkatës.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse dhe Agjencia e Auditimit (AAPAA) është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Të njoftohet për këtë vendim, Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Akredituar nga Bashkimi Evropian, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha